

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 644 Prot.

Tiranë, më 10.05 2017

VENDIM Nr. 83, datë 26.04.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi Kërkesën për miratim të *projektit "Ndërtimi i Shkollës 9 vjeçare Marie Kaçulini", në zonën arkeologjike "B" Durrës, subjekti Bashkia Durrës.*

VENDOSI:

1. Investitori duhet të kontraktojë një shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të paraqesë pranë Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (KKA) të radhës, konceptin e sondazheve arkeologjike për sheshin ku do zhvillohet projekti *"Ndërtimi i Shkollës 9 vjeçare Marie Kaçulini", në zonën arkeologjike "B" Durrës, subjekti Bashkia Durrës.*
2. Procedura e kryerjes së sondazheve arkeologjike do të vijojë sipas përcaktimeve të vendimit të KKA të radhës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO